

Eugjen Merlika - Fasada e martirëve

Contributed by Jozef Martini
Thursday, 09 October 2014

Fasada e martirëve

Eugjen Merlika

FASADA E MARTIRËVE

Eugjen Merlika

“Për mua ka qenë një e papritur : un nuk e dinja se populli juaj ka vuajtur aq shumë. Pastaj rrugës nga aeroporti në shesh gjithë këto fotografi të martirëve. Si keni mundur t’i mbijetoni kaqë mundimi ?”

Papa Françesku

Ditën e hënë, më 22 shtator 2014, të nesërmen e vizitës madhore të Papa Françeskut në Tiranë, dy gazeta të rëndësishme italiane, përkatësisht “La Repubblica” dhe “L’Osservatore romano” (“Vëzhguesi roman”), njëra një monument mediatik i së majtës dhe tjetra organi qëndror i Selisë së Shenjtë, në faqen e parë kishin dy fotografi të përfaqimit të Papës me Dom Ernest Simonin. Është një tregues i interpretimit të thelbit të vizitës historike të Kreut të Kishës Katolike botërore në Tiranë. “La Repubblica” e titullon kështu komentën e saj : “Lotët e Papës Françesku : Mos vrisni në emër të Zotit!”. “L’Osservatore romano” kishte titullin e faqes me shkronja të mëdha e të theksuara me të zezë : “Sot kemi prekur martirët”, ndërsa kryeartikulli titullohej “Dëshmi e vëllazërim”

“Janë dëshmia dhe vëllazërimi dy kyçet që lejojnë të përceptohet kuptimi i udhëtimit të Françeskut në Shqipëri. Sa i shkurtër 12 orë – aq i rëndësishëm dhe i pashembullt. I rëndësishëm për Vendin, që nga Papa ka marrë një mbështetje të fuqishme e i pashembullt për sinjalin që ai ka dashur t’i lëshojë Europës dhe gjithë bashkësisë ndërkombëtare.”

Ideja e shkrimit është e qartë : vihen në një plan dëshmia e martirizimit të shqiptarëve nga komunizmi me harmoninë fetare që gjëndet në Shqipëri e që duhet të shërbejë si mesazh ndriçues dhe inkurajues për botën e soçme, të cilitur nga kundërshtitë dhe luftërat ndërfitare. Fotografia në mes të faqes na zbulon përparësinë që, simbas gazetës, merr motivi i parë.

Pa u zgjatur më shumë në komentimin e vizitës, mund të them se ishte një sukses i shquar i shqiptarëve dhe i shtetit të tyre, me një notë lavdërimi për organizatorët. Në këtë sukses një rol të dorës së parë pati vendosja e portreteve të 40 martirëve të besimeve fetare në shëtitoren “Dëshmorët e Kombit”. Ishte e para herë që opinionit publik botëror, të pranishëm idealisht e mediatikisht në Tiranën e 21 shtatorit, i zbulohet pamja rrëqethëse e kimit komunist në realitetin e Shqipërisë së mbas luftës së dytë botërore. Kryeministrit Edi Rama që, simbas fjalëve të tij, ka patur dhe ka sendërtuar këtë ide tepër të spikatur, për sa më përket, duhet t’i shkojnë përgëzimet më të sinqerta.

E quaj atë veprim si fillimin e dekomunistizimit të vërtetë të Shqipërisë. Ngritja në pjedistal, në sytë e një miku të nivelit të Kreut të Katoliçizmit botëror e të gjithë organeve të medias që e shoqëronin, e viktimave të terrorit të Shtetit komunist në mënyrë kaq të shkëlqyer, duhet të jetë një shenjë sigurie se Shqipëria politike pas komuniste ka vendosur prerë të shkëpusë çdo lidhje me të shkuarën e saj. Mendoj se ky duhet të jetë përfundimi logjik në të cilin çon një veprim i tillë. Për të gjithë ata që nuk e njohin në thellësi realitetin e Shqipërisë pas komuniste ky vendim duket i pakundërshtueshëm. Por..... për ne që jetojmë, duke e pësuar mbi shpinë çdo ditë atë realitet, dyshimi është më se i ligjshëm. Dyshimi merr shembëlltërinë e

mosbesimit, si pasojë e zhgënjimeve të njëpasnjëshme që shoqëria shqiptare e kryesisht, pjesa e saj e përndjekur për gjysëm shekulli nga diktatura komuniste, ka provuar në këtë gati një të katërt qindvjetit të tjetërsimit të regjimit. Gjatë gjithë këtyre viteve, ajo pjesë ka qënë e pranishme në zbatimin në praktikë të idesë së njohur ramiziane "Shqipërinë do t'a gëzojmë ne dhe fëmijët tanë.". Ajo ka qënë prë e demagogjisë së përbindëshme që është ushtruar mbi të dhe të drejtat e saj, duke mbetur përsëri shtresa e nëpërkëmbur, e gënijer, e tradhëtuar, herë herë edhe nga vetë përfaqësuesit e saj.

Jo pak mund të jenë në kundërshtim me këtë paraqitje të zymtë të realitetit, por skeptikëve të kësaj tabloje do t'u lutesha të vërtetimin të kundërtën e saj.

E kundërta do t'ishte, së pari, dhënia e dëmshpërblimeve për punën e papaguar në burgjet dhe kampet e internimit për dhjetra mijra njerëz, shumica e të cilëve nuk jeton më. Në 23 vjet Shteti shqiptar ka dhënë vetëm një këst, në rastin më të mirë dy të tillë. Ky është fakti i hidhur e, për mendimin tim, i pajustificuar. Gjatë këtyre 23 vjetëve, në politikën shqiptare, janë miza të bardha eksponentë të saj me prejardhje të përndjekurish, madje duke marrë parasysh edhe shkollimin e moshave të reja në universitetet e Perëndimit. Disa emërime në nivele të mesme të administratës shtetërore aktuale janë përjashtime që forcojnë rregullin. Shumë prej ish të përndjekurve, për 20 vjet nuk kanë patur mundësi as të hyjnë në shtëpitë e tyre të shtetëzuara nga dhuna komuniste, madje ende sot, shumica dërmuese nuk është në gjëndje të marrë pronat e vogla, mbasi pengesat e parafabikuara burokratike, të ndërthurura me regjimin korruptiv të drejtësisë e administratës publike, janë të pakapërcyeshme.

Nxënësve të shkollave në Shqipëri u mësohet ende historia e shtrembëruar e regjimit komunist, madje ato tekste përdoren edhe në shkollat e Kosovës. Dizinformimi komunist vazhdon si në kohën e regjimit, madje në krye të komisionit të rishkrimit të historisë para universitare, emërohet një nga historianët më në zë t'atij regjimi!!! Antikomunizmi vazhdon të quhet "armiçësor" për interesat e Vendit dhe ajo vlerë e madhe e qëndresës dhjetëvjeçare në malet e Shqipërisë së veriut, mbetet krejtësisht e panjohur.

Kasta politike vazhdon të pasurohet në mënyrë prrallore e, çuditërisht, në këtë aradhe pasanikësh të rinj nuk ka asnjë ish të përndjekur politik. Këto ishin vetëm disa nga pamjet e jetës së sotme shqiptare, në të cilën vizita e Papës Françesku, uroj të ketë kryer funksionin e një ndarësi epokash. Nëse imazhi i dhënë më 21 shtator nuk është vetëm një fasadë e ngjyrosur, për të forcuar idenë se Shteti dhe shoqëria jonë i përkasin kryekëput, në gjithë qënien e tyre botës Perëndimore, idealeve e parimeve të saj, atëherë përballimi me problemet e mësipërme bëhet i detyrueshëm e kohët e tij nuk mund të jenë ato të vërejtura në këta 23 vjet.

Portretet e martirëve të fesë në Shëtitorën "Dëshmorët e Kombit" nuk janë vetëm dëshmi e kujtesës historike, si një njësi matëse e përmasave të krimit komunist, janë dhe një thirrje që buron nga vetëdija e kombit, për të dënuar haptas e pa mëdyshje këtë të fundit, jo vetëm me fjalë. Lotët e Papës Françesku, një njeri që vjen nga Argjentina, Vëndi i desaparesidëve e i diktaturës ushtarake gjakatare, kur mëson vetëm majën e ajsbergut të krimit shtetëror shqiptar nga rrëfimet e Dom Ernest Simonit apo murgeshës Marije Kaleta, nxjerrin në dukje krahasimin e dy dhunave e tregojnë se çfarë përmasash shkatërruese pati ajo në "Vendin e shqipeve".

Dënimi i krimit komunist duhet të shkojë me të njëjtin hap me rikthimin e të drejtave të viktimave të tij, së pari atyre lëndore, si dëmshpërblimet e premtuara e të zvarrisura në "kalendat greke". Por ai duhet të nënëkuptojë edhe rivlerësimin e së shkuarës jo komuniste, për t'i hapur rrugën jo vetëm pohimit të së vërtetës historike, por edhe paqimit kombëtar për të cilin kemi shumë nevojë në rrugën e zhvillimit.

A do të jetë në gjëndje ideatori i vendosjes së portreteve të ndërmarrë seriozisht e sinqerisht këtë rrugë të vështirë, por të domosdoshme për të sotmen e t'ardhmen e Shqipërisë ? Pyetja mbetet pa përgjigje. Për çastin ajo nuk mund të jetë mohuese, sepse sinjalin e 21 shtatorit, deri në provë të kundërt, duhet t'a quajmë tregues të vlefshëm. Nuk mund të jetë as pohuese, mbasi argumentin nuk e gjejmë të trajtuar në asnjë nga daljet e shpeshta të Kryeministrit në qytetet e Shqipërisë apo në televizionet e saj. Premtimet për fonde publike në ndryshimin e pamjeve të qyteteve tona, në ndërtimin e rrugëve apo veprave sociale, janë të lëvdueshme e uroj që të jenë realiteti i viteve t'ardhëshme. Por pagimi i dëmshpërblimeve të ish të përndjekurve politikë duhet të ketë përparësi absolute, jo vetëm se është një borxh që Vendi i ka viktimave të komunizmit, një borxh moral e lëndor mudi, djerse, gjaku, një borxh jetësh njerëzore, që nuk paguhet as me gjithë arin e botës.

Nëse me të vërtetë ekziston prirja për të ndryshuar rrugë, për t'i dhënë përmbajtje imazhit të 21 shtatorit, duhen braktisur kriteret qesharake e mashtruese të ndjekura deri tani e të caktohet një periudhë, jo më shumë se tre vjet, për të shlyer gjithë pagesat në dobi të ish të përndjekurve politikë. Do të ishte hapi i parë i madh në kthesën e vërtetë, që duhet të pasohet edhe nga shumë masa të tjera që shkojnë n'atë drejtim. Dihën vështirësitë financiare të Shtetit, por askush nuk mund të më bindë se, në këta 23 vjet, nuk ka patur asnjë mundësi të bëhej më shumë, ka munguar vullneti politik. Një Vend, në të cilin lëvizin pasuri marramendëse miliarda dollarësh, nuk ka asnjë vështirësi të gjejë pak qindra milionë që plotësojnë dëmshpërblimet.

Nëse nuk i gjen, do të thotë se nuk don t'i gjejë e, n'atë rast do të thosha se vazhdon mashtrimi i madh e se 21 shtatori ka qënë vetëm një fasadë. I a lemë kohës të vërtetë shpresat e dyshimet e shumta, të lindura në një ditë të madhe të historisë sonë.

Shtator 2014

